

NOTË INFORMUESE

Mbi kërkesën e ILD për përfundim pa vendim të procedimit disiplinor ndaj ish magjistrates M.F.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nisur hetim disiplinor me 29.07.2024 ndaj magjistrates M. F., prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me nismë të ankuesit dhe më 13.12.2024 ka nxjerrë vendim për shtimin e objektit të hetimit disiplinor ndaj magjistrates në fjalë, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronjat “ç” “d” dhe “ë” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në përfundim të hetimit disiplinor të kryer, më 25.04.2025 ILD ka depozituar në KLGJ raportin e hetimit me kërkesën për procedim disiplinor ndaj magjistrates M. F. dhe në mbështetje të nenit 105 shkronja “c” nën-pika i), dhe neni 108 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është kërkuar caktimi i masës disiplinore “Ulja e përkohshme e pagës”.

Ndërkohë, me vendimin e datës 10.06.2025, Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) ka ndryshuar vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe ka vendosur shkarkimin nga detyra të M.F. Ky vendim, në bazë të Kushtetutës dhe ligjit për rivlerësimin kalimtar ka efekt të menjëhershëm dhe sjell përfundimin e ushtrimit të detyrës.

Për pasojë, M.F. nuk e gëzon më statusin e magjistratit dhe nuk është më subjekt i kompetencës së KLP-së për procedimin disiplinor. Në këto kushte, procedimi disiplinor i nisur më parë ka mbetur pa objekt dhe pa qëllim të realizueshëm.

Duke u bazuar në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit procedura administrative përfundon pa një vendim përfundimtar kur objekti ose qëllimi i saj bëhet i pamundur, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë që të vendosë *përfundimin e procedimit disiplinor ndaj ish-magjistrates M.F. pa dhënë një vendim përfundimtar.*